



14. Secila nga format e mëposhtme është formuar duke ngjitur bashkë kube të njëjtë. Secila formë lyhet me bojë. Cila nga format ka sipërfaqen më të vogël?



15. Dyshemeja është shtruar me pllaka të njëjta drejkëndore. Brinja e shkurtër e çdo pllake drejkëndore është 1 m. Sa është gjatësia e dyshemesë, e cila është shënuar me pikëpyetje?



- (A) 6 m (B) 8 m (C) 10 m (D) 11 m (E) 12 m

16. Në mëngjes, orën 6:00 treni nisët nga stacioni me emër “KANG” dhe kalon në tre stacione pa u ndalur, përpara se të arrijë në stacionin e fundit “AROO”.



Numrat në figurë tregojnë sa orë i duhen trenit për të shkuar nga njëri stacion në tjetrin. Nëse treni mbërrin në stacionin e fundit “AROO” në orën 11:00 të darkës, sa kohë i është dashur trenit për të përshkuar rrugën ndërmjet stacionit të parafundit dhe stacionit “AROO”?

- (A) 2 orë (B) 3 orë (C) 4 orë (D) 5 orë (E) 6 orë

Problema me 5 pikë






17. Në një fermë ka vetëm dele dhe lopë. Numri i deleve është 8 më shumë se ai i lopëve. Numri i lopëve është sa gjysma e numrit të deleve. Sa kafshë ka gjithsej në fermë?

- (A) 16 (B) 18 (C) 20 (D) 24 (E) 28

18. Një figurë është prerë në tre pjesë, si në vijim:



Cila nga figurat e mëposhtme mund të jetë figura e paprerë?

- (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 


19. Në kopshtin zoologjik janë 10 deve. Disa prej tyre kanë dy gunga në kurriz dhe të tjetrat ka vetëm një gungë. Gjithsej numërohen 14 gunga. Sa deve kanë dy gunga?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

20. Tre ketrushat Ani, Arlisa dhe Eli mblodhën gjithsej 7 bajame. Secili nga ketrushat mblodhi numër të ndryshëm bajamesh dhe secili ka mbledhur të paktën një bajame. Nëse Ani ka mbledhur numrin më të vogël të bajame dhe Arlisa ka mbledhur numrin më të madh të bajameve, sa bajame ka mbledhur Eli?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

21. Tini dhe Tomi pasi ndërtuan një kështjellë prej rëre, i vendosën asaj në majë një flamur. Ata ngulën shkopin e flamurit në pikën më të lartë të kështjellës, duke lënë gjysmën e shkopit të flamurit jashtë. Maja e shkopit është 80 cm lart nga toka. Skaji i e poshtëm i shkopit është 20 cm lart nga toka. Sa e lartë është kështjella e rërës që ndërtuan shokët?



- (A) 40 cm (B) 45 cm (C) 50 cm (D) 55 cm (E) 60 cm



22. Në këtë figurë janë 9 kuba:

Fillimisht, Ani zëvendësoi të gjithë kubat e zinj me kuba të bardhë.

Më pas, Beni zëvendësoi të gjithë kubat gri me kuba të zinj.

Në fund, Kristi zëvendësoi të gjithë kubat e bardhë me kuba gri. Cila është figura përfundimtare?




23. Petriti zgjodhi një katror me katër kuti nga tabela me numra, si në figurë. Shuma e 4 numrave që zgjodhi ai ishte më e madhe se 63. Cili nga numrat e mëposhtëm ndodhet në çdo katror që mund të zgjedhë Petriti?


1	2	3	4	5
6	7	8	9	10
11	12	13	14	15
16	17	18	19	20

- (A) 14 (B) 15 (C) 17 (D) 18 (E) 20

24. Ambla ka një makineri që kthen monedhat. Një monedhë të zezë ajo e kthen në tre monedha të



bardha, ndërsa një monedhë të bardhë e kthen në dy monedha të zeza.



Ambla ka tre monedha të zeza dhe një të bardhë: . Ajo e përdori makinerinë tre herë. Sa është numri më i vogël i monedhave që mund të ketë në fund Ambla?

(A) 7

(B) 6

(C) 8

(D) 5

(E) 9